



Departamenti Financë-Kontabilitet

Departamenti Financë-Kontabilitet është themeluar në vitin 2007, në të njëjtin vit me krijimin dhe ristrukturimin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Ky departament është krijuar duke ruajtur vazhdimësinë e dy katedrave, të Financës dhe Kontabilitetit, që kanë ekzistuar deri në vitin 1994. Departamenti Financë Kontabilitet është organizuar në përputhje me Statutin e UBT, duke pësuar ndryshime sasiore dhe cilësore. Numri i stafit akademik sot është 17 pedagogë, të cilët janë të organizuar në dy grupe mësimore shkencore, Financë dhe Kontabilitet. Stafi i departamentit ka një nivel të lartë kualifikimi në kategoritë Profesor (42%) dhe Doktor Shkencash (47%). Programet që ofron departamenti sigurojnë zbatimin e standardeve të edukimit duke rritur mundësitë e bashkëpunimit në kuadër të projekteve të Bashkimit Europian (ERASMUS+) me qëllim rritjen e kapaciteve akademike dhe shkëmbimeve të studentëve me universitete të njohura jashtë vendit.

Bëhu profesionist në programet tona

CILAT JANË FUSHAT PRIORITARE TË KËRKIMIT TË DEPARTEMENTIT?

- Menaxhimi financiar dhe strategjia e zhvillimit në sektorin publik dhe në sipërmarrje private.
- Vendimmarrja dhe strategjitë financiare në njësitë ekonomike.
- Drejtimi i riskut të biznesit dhe riskut financiar në njësitë ekonomike dhe në institucionet financiare.
- Diagnostikimi dhe analiza e problemeve të financimit të sektorit bujqësor dhe të sektorëve të tjerë ekonomikë.
- Politikat monetare dhe fiskale në kuader të mbështetjes së sipërmarrjes private dhe zhvillimit ekonomik.
- Edukimi financiar dhe roli i tij në nxitjen e sipërmarrjes dhe të karrierës.
- Implementimi i Standardeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit në njesitë ekonomike.
- Edukimi kontabël dhe auditues në kuadër të Standardeve të SKK-ve dhe SNKV-ve.
- Forcimi i cilesisë së raportimit financiar dhe rritja e besueshmërsisë së informacionit kontabël të njësive ekonomike.
- Rritja e kapaciteteve teknike të profesionit të financierit, kontabilitetit dhe auditimit për të kuptuar dhe komunikuar sistemin modern të publikimit të gjendjes financiare, për kryerjen e analizave të pasqyrave financiare.
- Njohja me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël, mbështetur në kompetenca, për nxitjen e mësimnxënies gjatë gjithë jetës.

ÇFARË OFRON KY DEPARTAMENT?

Cikli i tretë i studimeve	Viti 3 Viti 2 Viti 1	Studime doktorature		
		↑		
Cikli i dytë i studimeve	Viti 2 Viti 1	Diploma Master shkencor (120 kredite)	Diploma Master profesional Financë-Bankë (120 kredite)	Diploma Master profesional Kontabilitet-Auditim (120 kredite)
		↑	↑	↑
Cikli i parë i studimeve	Viti 3 Viti 2 Viti 1	Diploma Bachelor (180 kredite)		

CILËT JANË MODULET (LËNDËT) KRYESORE QË OFRON PROGRAMI?

MODULE TË FORMIMIT NË SHKENCAT BAZË:

Matematikë, Matematikë Financiare, Statistikë, Statistikë Biznesi, Sociologji.

MODULE TË FORMIMIT PROFESIONAL:

- **të përgjithshme:** Mikroekonomi, Makroekonomi, Drejtim i Fermave, Bazat e Agrobiznesit, Marketing Agroushqimor, Administrimi Publik, Drejtimi i Operacional;
- **të profesionit:** Bazat e Financës, Financat Publike, Paraja dhe Bankat, Financa Rurale, Tregjet dhe Inst. Financiare, Investimet, Taksim, Drejtim Financiar, Bazat e Kontabilitetit, Kontabiliteti Financiar, Kontabilitet i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit, Analiza Financiare, Kontabiliteti i Kostos, Kontabilitet Drejtimi, Auditim, Raportim Financiar, Drejtim Portofoli, Kontabilitet Bankar, Kontrolli & Auditi i Bbrendshëm.

MODULE INTEGRUESE/PLOTËSUESE:

Prodhim bimor, Prodhim shtazor, Gjuhë e huaj, Informatikë, Njohuri mbi Informacionin, Menaxhim Karriere.

PUNËSIMI POTENCIAL PAS STUDIMEVE

Të diplomuarit në Financë-Kontabilitet kanë **mundësi shumë më të lartë punësimi** se kategoritë e tjera të të diplomuarve: • Institucionet dhe organizatat financiare: në institucionet financiare dhe bankare, si edhe në institucionet financiare; jobankare; • Sektorin privat: në njësitë ekonomike private/OJF; • Sektori publik: në institucionet publike në nivel qendror dhe lokal; • Institucionet e Arsimit të Lartë: në arsimit publik dhe privat; • Institucionet e kërkimit shkencor: në qendra dhe kompani të kërkimit shkencore, publike dhe private; • Tregu jo-financiar: në tregun e sigurimeve; • Tregun e pasurive të paluajtshme; etj.